



БАТЕРИИ – ОПАСНОСТ ИЛИ МОЖНОСТ? ЗАШТЕДА НА РЕСУРСИ ПРЕКУ РЕЦИКЛИРАЊЕ БАТЕРИИ



Konrad
Adenauer
Stiftung



NORWEGIAN EMBASSY


GoGreen



EMBASSY OF SWEDEN



Антонио Јовановски




BATERITË – RREZIK OSE MUNDËSI?

KURSIMI I ENERGJISË DHE RESURSEVE PËRMES RICIKLIMIT TË BATERIVE

Antonio Jovanovski
Go Green Shkup

prill 2014



Falënderim të veçantë për Ana Karanfilova Maznevskaja, Helena Gustavson Valund, Biljana Xhartova-Petrovska, Lars Eklund, Marjanço Dameski dhe Valentina Kashuba për informacionet dhe për mbështetjen në procesin e hartimit të këtij Manuali.

IMPRESUM

Titulli:

Bateritë – rrezik ose mundësi?
Kursimi i energjisë dhe resurseve përmes riciklimit të baterive

Botues:

Fondacioni Konrad Adenauer në Reepublikën e Maqedonisë

Autor:

Antonio Jovanovski, Go Green Shkup

Bashkërenditja:

Daniella Popovska

Përkthim nga maqedonishtja:

Blerina Starova Zlatku

Shtypi:

Vinsent Grafika

Tirazhi:

100

Publikimi mund të shkarkohet falas në:
<http://www.kas.de/mazedonien/en/publications/>
<http://www.gogreen.mk/>

Vërejtje:

Qëndrimet e paraqitura në këtë publikim nuk janë qëndrime të Fondacionit Konrad Adenauer, por janë pikëpamje të autorit. Njëkohësisht Fondacioni Konrad Adenauer nuk merr përgjegjësinë për gabimet eventuale të përkthimit nga maqedonishtja në shqip.

Ky publikim ndërlidhet me projektin për mbetjet e baterive GO GREEN që mbështet zbatimin e Ligjit për bateri dhe akumulatorë dhe mbetjet e baterive dhe akumulatorëve dhe synon të vendos një sistem të qëndrueshëm për menaxhimin e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve në Republikën e Maqedonisë. Projektin e mbështesin Fondacioni Konrad Adenauer, Ministria e Mjedisit të Republikës së Maqedonisë, Ambasada e Norvegjisë në Beograd dhe Ambasada e Suedisë në Shkup.

Përmbajtja:

1. Bateritë – rrezik ose mundësi?	4
2. Bateritë – nocione kryesore	5
3. Llojet e baterive dhe përdorimi i tyre	6
4. Çka ndodhë kur bateritë i hedhim në kazanin e mbeturinave?.....	8
5. Çka fitohet me riciklimin e baterive?	9
6. Vështrim i shkurtër mbi Ligjin për bateri dhe akumulatorë dhe mbetje të baterive dhe akumulatorëve në RM	10
6.1 Qëllimi i ligjit	10
6.2 Qëllimet nacionale për grumbullimin e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve	11
6.3 Obligimet e prodhuesve	12
6.4 Obligimet e tregtarëve dhe poseduesve	13
6.5 Obligimet e qytetarëve	13
6.6 Obligimet e komunave	13
6.7 Obligimet e operatorëve kolektiv	14
6.8 Obligimet e inspektorëve të mjedisit jetësor dhe sanksionet	14
7. Gjendja në Maqedoni	16
7.1 Operatorë kolektiv	17
7.2 Trajtimi dhe përpunimi	19
7.3 Vetëdija publike dhe edukimi	19
7.4 Bashkëpunimi ndërkombëtar	20
8. Përvojat e suedisë	20
9. Sfidat dhe mundësitë: Mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike ...	25
10. Rekomandime për zhvillimin e një sistemi të suksesshëm	26
Literatura e përdorur	28

1. BATERITË – RREZIK OSE MUNDËSI?

Me miliona bateri, për çdo ditë përdoren dhe hiqen nga përdorimi. Bateritë na sigurojnë energji në çdo vend ku kemi nevojë për të njëjtën, pa marrë parasysh rrjetin shpërndarës. Me zhvillimin e teknologjisë dhe me rritjen e prodhimit të produkteve të teknologjisë së lartë, shtohet edhe nevoja për bateri. Me rritjen e numrit të baterive rritet edhe përgjegjësia për sasinë e madhe të baterive të cilat hiqen nga përdorimi.

Shtrohet pyetja: cilat janë rreziqet nga mbetjet e baterive, ndërkaq cilat janë mundësitë që rezultojnë nga vendosja e një sistemi të suksesshëm për menaxhimin me mbetjet e baterive? Nga njëra anë, ato përmbajnë substanca, të cilat nuk guxojnë të rrjedhin në mjedisin jetësor, ndërsa nga ana tjetër, metalet që i përmbajnë bateritë mund të riciklohen pafundësisht. Me riciklimin e metaleve, të cilat i përmbajnë bateritë, realizohet një kursim i energjisë prej 45% deri në 90%, në krahasim me procesin e prodhimit të metaleve përmes përpunimit të mineraleve. Një potencial shtesë për kursimin e energjisë dhe resurseve janë mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike (MPEE), ku bateritë janë pjesë e pashmangshme e prodhimeve, ndërkaq sistemi bazohet mbi parimet e njëjta. Faktorët dhe pjesëmarrësit e zhvillimit të një sistemi të suksesshëm për menaxhim me mbetjet e baterive dhe të MPEE janë të ndryshme. Prodhuësit e baterive, të cilët në këtë rast paraqiten si "ndotës", duhet të investojnë më së shumti në këtë sistem që në fund të kenë leverdi dhe të kenë përfitime nga i njëjti. Përgjegjësia e prodhuësit do të përmbushet vetëm atëherë kur të gjitha bateritë e harxhuara do të grumbullohen dhe do të ripërpunohen. Që të mundësohet një sistem i këtillë rol kyç kanë komunat dhe qytetarët.

Ky Manual fokusohet mbi bateritë portative dhe ka për qëllim t'u ndihmojë komunave që ta implementojnë me sukses Ligjin për bateri dhe akumulatorë dhe mbetje të baterive dhe akumulatorëve ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 140/10, 47/11 dhe 148/11) dhe t'i stimulojë të gjithë pjesëmarrësit e sistemit që të marrin rol aktiv në krijimin e qëndrueshmërisë dhe shfrytëzimin e përfitimeve. Manuali jep një përshkrim të sistemit të menaxhimit të baterive dhe akumulatorëve, i prezanton përfitimet nga seleksionimi dhe riciklimi i baterive, e prezanton gjendjen në Republikën e Maqedonisë në këtë fushë, dhe si shembull e prezanton përvojën e Suedisë dhe e thekson potencialin e këtij sistemi.

Vendosja e një sistemi të qëndrueshëm për menaxhim me mbetje të baterive është proces afatgjatë, i cili kërkon investime dhe angazhim nga të gjitha palët e përfshira. Të gjithë pjesëmarrësit, prodhuësit, komunat,

qytetarët dhe inspektorët e mjedisit jetësor duhet të përfshihen në mënyrë të barabartë, me qëllim që të shfrytëzohen mundësitë e grumbullimit dhe riciklimit të baterive. Investimet dhe përfitimet janë të mëdha, ndërsa dështimi eventual ka ndikim të fatal mbi mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve.

2. BATERITË – NOCIONE KRYESORE

Bateria është pajisje elektrokimike në të cilën është akumuluar energji kimike, në formë të energjisë potenciale, e cila konvertohet në energji elektrike kur skajet e baterive, elektrodën do të bashkohen me përçues. Bateritë na krijojnë mundësi të jemi të pavarur nga rrjeti elektrik dhe janë pjesë e domosdoshme e përditshmërisë sonë. Për faktin e se përbërja e tyre përmban elemente kimike-toksike, përkatësisht metale të rënda, ato bëjnë pjesë në kategorinë e mbetjeve të rrezikshme.

Ligji për bateri dhe akumulatorë dhe mbetje të baterive dhe akumulatorëve "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 140/10, 47/11 dhe 148/11) i përkufizon nocionet si vijojnë:

Bateri ose akumulatorë, është çdo burim i energjisë elektrike që gjenerohet nga konvertimi i drejtpërdrejtë i energjisë kimike dhe që konsiston me një ose më shumë qeliza baterish primare (të pakarikueshme) apo që konsistojnë në një apo më shumë qeliza baterish sekondare (të karikueshme);

Paketë baterish, është çdo komplet baterish ose akumulatorësh që janë të lidhur së bashku dhe/ose të mbyllura në formë kapsolle brenda së njëjtës mbulesë të jashtme dhe që përbëjnë një njësi të vetme, që përdoruesi përfundimtar nuk e ndan ose nuk e hap;

Bateri portative, është çdo bateri, pilë në formë kopse, paketë baterish ose akumulator që janë të vulosura, mund të mbahen në dorë, nuk janë as bateri ose akumulator industrial, as bateri ose akumulator automjeti;

Pilë në formë kopse, është çdo pilë portative e vogël, e rrumbullakët ose akumulator që e ka diametrin më të madh se lartësia e vet dhe që përdoret për qëllime të veçanta, si p.sh. në aparate dëgjimi, orë, pajisje të vogla portative dhe pajisje për energji emergjence;

Bateri ose akumulator automjeti, është çdo bateri ose akumulator që përdoret si pajisje për ndezje dhe ndriçim të automjetit;

Bateri apo akumulator industrial, është çdo bateri apo akumulator i projektuar vetëm për përdorime industriale apo profesionale ose për përdorim në çdo lloj mjeti elektrik.

3. LLOJE TË BATERIVE DHE PËRDORIMI I TYRE

Bateritë kryesisht ndahen në bateri portative dhe automjeti.

Bateritë portative ndahen në:

- Primare ose bateri për një përdorim dhe
- Sekondare ose bateri të karikueshme

Bateritë primare, për shkak të përbërjes së tyre kimike të baterive alkale, qeliza baterish zink-ajër dhe oksid argjendi në formë kopse sipas ligjit nacional, lejohet të përmbajnë deri më 25 miligram zhivë.

Bateritë sekondare përmbajnë plumb dhe kadmium.

Sipas hulumtimit të OJQ “Metamorfozis”, të vitit 2011, 61% e popullatës përdor bateri primare për një përdorim, ndërsa bateri sekondare me karikim përdorin vetëm 25% e popullatës.

Ndarja e detajuar e baterive, si dhe përmbajtja dhe përdorimi i tyre, është pasqyruar në tabelën 3.1

Lloji i baterive	Ku përdoren?	Informata interesante
Alkale, Alkal - mangan, 9-Volt, D, C, AA, AAA, Alkale në formë kopse	Telekomandë, lodra për fëmijë, alarm për tym, pompa, pajisje për diagnostifikim, defibrilatorë, bateri ndriçimi, gleukometra, pajisje telemetrike, etj.	Bateri më të popullarizuara primare për një përdorim. Ky tip i baterive i ka zëvendësuar bateritëe vjetra me zink-karbon. Disa lloje riciklohen me qëllim që të përpunohet zhiva, ndërsa ato të prodhimit më të ri riciklohen me qëllim që të përpunohet zinku.

Litium, në formë kopse, AA, AAA, 9-Volt, të vogla cilindrike Jon-litium	Orë, kamera, alarme, kalkulatorë, lodra për fëmijë Telefona celulare, laptopë, video-kamera, mp3 player	Bateri të kohës moderne, veçanërisht tipi i dytë i baterive. Tipi i parë janë bateri primare për një përdorim, ndërsa tipi i dytë janë sekondare dhe të rikarikueshme. 90% e këtyre baterive riciklohen dhe përpunohet litiumi dhe aliazh litiumi; Nuk duhet të digjen meqë litiumi shpërthen lehtë.
Oksid argjendi ose argjend – zink Në formë kopse Me Voltazh të lartë, të vogla cilindrike	Pajisje mjekësore, orë, kamera, ndërsa kohëve të fundit edhe në kompjuterë laptop dhe telefona celulare	Përmbajnë zhivë dhe bëhen toksike pasi të rrjedhin pas disa vitesh, ndërkaq më së shpeshti pas pesë vitesh (që zakonisht është jetëgjatësia e tyre). Rrjedhja e zhivës shkakton probleme serioze shëndetësore. Edhe këto bateri riciklohen me qëllim që të përpunohet zhiva, zinku dhe argjendi, të cilët ipërmbajnë. Nga ky tip ka bateri primare dhe sekondare.
Zhivë, zhivë-oksidi (Cilindrike ose katrore, në formë kopse)	Kamera, orë, pajisje mjekësore siç janë: pejsmerkerë, defibrilatorë, eko-monitorë, monitorë të shëndetësisë, pejxherë, pajisje për telemetri alarme për temperaturë dhe në pajisjet për analizën e gjakut	Zhiva është njëri nga metalet më toksikë dhe për këtë shkak këto bateri, në vendet me zhvillim të lartë hiqen nga përdorimi. Megjithatë, bëhet fjalë për një proces afatgjatë, ndërkaq kërkesa është akoma e madhe. Me vëmendje të veçantë duhet të trajtohen dhe menjëherë të selektohen dhe të depozitohen në koshat e mbeturinave për mbetjet ebaterive. Këto bateri riciklohen me qëllim që të përpunohet zhiva.
Nikel - kadmium, 9-Volt, C, D, AA, AAA	Pajisje portative të komunikimit dhe defibrilatorë	Përmbajnë nivel shumë të lartë të nikelit dhe kadmiumit – dy metale të rënda. Për shkak të nivelit të lartë toksik, këto bateri, në vendet e zhvilluara, kanë tatim më të lartë dhe kërkesa shënon rënie. Menjëherë duhet të selektohen ashtu si edhe bateritë me zhivë. Riciklohen sikurse edhe bateritë paraprake me qëllim të përpunimit të metaleve.

Nikel – zink, AA	Disa vegla, telefona, kamera digjitale, aparate të cilat punojnë mendihmën e baterive, ndërkaq përdoren në kopshte, fotoaparate profesionale, biçikleta elektrike dhe ngjashëm	Këto bateri nuk përmbajnë metale të rënda. Zinku dhe nikeli mund të riciklohen plotësisht. Kjo teknologji e re revolucionare është në rritje dhe synon t'i zëvendësojë në treg bateritë aktuale toksike me nikel-kadmium.
-----------------------------	---	--

TABELËN 3.1

Një hulumtim i zbatuar në vitin 2010 nga organizata joqeveritare 4x4x4 Ballkanski Mostovi (Ura Ballkanike), tregon se në Maqedoni tregtohet me:

- ✓ 4,5V (3R12) lanterna, (pesha e një baterie: 44,7 g)
- ✓ D (R20) bateri dore, (pesha e një baterie: 33,6 g)
- ✓ C (R14) bateri dore, (pesha e një baterie: 29,8 g)
- ✓ AA (R6) bateri dore, (pesha e një baterie: 20,1 g)
- ✓ AAA (R03) bateri në formë të stilolapsit, (pesha e një baterie: 18,7 g)
- ✓ AAAA (LR8D425) bateri, (pesha e një baterie: 17 g)
- ✓ 9-Volt (6LR61) bateri "katërkëndëshe", (pesha e një baterie: 37 g)
- ✓ Bateri litiumi në formë kopse (pesha e një baterie: 1,9 g)
- ✓ LR44 pilë në formë kopse (pesha e një pile: 2,6 g)

4. ÇKA NDODH NË RASTET KUR BATERITË I HEDHIM NË KAZANIN E MBETURINAVE?

Në rastet kur bateritë i hedhim bashkë me mbetjet urbane ato përfundojnë në vendgrumbullimet e mbeturinave në të cilat metalet e rënda që i përmbajnë kanë potencial që gradualisht të filtrohen në tokë dhe në ujërat nëntokësor. Toka dhe uji i kontaminuar ndikojnë mbi kualitetin e ushqimit të kafshëve dhe rrjedhimisht me këtë edhe mbi produktet ushqimore të cilat i marrim nga toka, si edhe qumështi, djathi etj. tek të cilët vërehet një nivel më i lartë i metaleve të rënda. Sasia e rritur e metaleve të rënda në organizmin e njeriut shkakton: dhembje koke, vështirësi abdominale, sulme epileptike, deformim të sistemit të eshtrave, osteoporozë, sterilitet,

kancer, gjendje kome, madje edhe vdekje. Në shumë raste mbeturinat digjen në vendgrumbullimet e mbeturinave ose në furra (inceneratorë) dhe kur metallet digjen ato përqendrohen tek hiri, i cili krijohet gjatë djegies, ndërkaj depërtojnë edhe në atmosferë, përmes gazrave që emetohen nga oxhaqet.

Problemi është serioz, pasojat - fatale!

Velesi, vite me radhë, helmohej me metale të rënda të cilat i emetonte metalurgjiku. Toka, në mjedisin më të gjerë, është e ndotur me metale të rënda, kryesisht me plumb dhe zink. Spinaqi dhe lakra e Velesit madje kanë edhe deri në 15 herë më shumë plumb sesa kufijtë e lejuar maksimal. Popullata ka jetëgjatësi më të shkurtër në Maqedoni. Rreth 34% e fëmijëve, të moshës prej 8 deri 10 vjet, kanë predispozita për leucemi. Në të kaluarën, Velesi ishte qyteti më i ndotur në Ballkan, ndërkaj nga Organizata Botërore e Shëndetësisë ishte shpallur si vend kritik për jetesë. Çdo bateri potencialisht është një "metalurgjik" i vogël me metale të rënda, ndërsa nga sjellja e papërgjegjshme pasojat mund të jenë fatale.

Për shkak të rrezikut, të cilin mund ta shkaktojnë bateritë dhe akumulatorët, ato rregullohen me Ligj i cili ka për qëllim të vendos një sistem të qëndrueshëm për menaxhimin me bateri dhe akumulatorë dhe me mbetjet e baterive dhe akumulatorëve.

5. ÇKA FITOHET ME RICIKLININ E BATERIVE?

Me riciklimin e metaleve që i përmbajnë bateritë realizohet kursimi i energjisë prej 45% deri në 90% në krahasim me procesin e prodhimit përmes përpunimit të mineraleve. Përfitimet mund t'i ndajmë në dy drejtime: kursim të energjisë dhe lëndëve të para.

Për t'u prodhuar një bateri nevojitet sasi e madhe e energjisë, e cila investohet nga procesi prodhues e deri në procesin e shitjes. Procesi i prodhimit fillon që në minierë, me eksploatimin e metaleve të rënda nga toka, pastaj transportin e mineraleve, përpunimin dhe ripërpunimin, transportin deri te fabrika e baterive, deri te tregu i repromaterialeve, deri te grosistët, deri te shitja me pakicë dhe kështu deri te përdoruesit e fundit – industria dhe qytetarët.

Përveç kursimit të energjisë, resurset të cilat fitohen nga riciklimi i baterive kanë një rëndësi të madhe. Me riciklimin e baterive fitohen metale (zink, plumb), pastaj sulfat sodiumi (detergjent), polipropilen, etj.

Me riciklimin e baterive mbrohet mjedisi jetësor dhe shëndeti i njerëzve, kursehet energjia dhe resurset, reduktohen shpenzimet dhe rinovohen resurset e nevojshme për degë të ndryshme të industrisë.

Kursimi i energjisë nga materiali i ricikluar, në raport me materialin origjinal nga pajisjet elektrike dhe elektronike (MPEE), që përmban lloje të ndryshme të baterive, është pasqyruar në tabelën si vijon.

Materiali	Alumini	Bakri	Hekuri/Çeliku	Plumbi	Zinku
Kursimi i energjisë (%)	95	85	74	65	60

TABELËN 5.1

6. VËSHTRIM I SHKURTËR MBI LIGJIN PËR BATERI DHE AKUMULATORË DHE MBETJE TË BATERIVE DHE AKUMULATORËVE NË RM

Republika e Maqedonisë e ka transponuar Direktivën e BE-së 2006/66/KE në vitin 2010, me miratimin e Ligjit për bateri dhe akumulatorë dhe mbetje të baterive dhe akumulatorëve në Kuvendin e RM-së. Ndryshimet e fundit u bënë në nëntor të vitit 2013 kur Bashkimi Evropian e miratoi Direktivën 2013/56/BE, ndërsa ndryshimet janë bërë në pjesën e hedhjes në treg të baterive dhe akumulatorëve portativë, të cilët përmbajnë kadmium dhe qeliza me zhivë në formë kopse. Më shumë informacione për Direktivën e fundit të BE-së, lidhur me bateritë dhe akumulatorët, mund të gjeni në ueb-faqen e Komisionit Evropian: <http://ec.europa.eu/environment/waste/batteries/>

Ligji për bateri dhe akumulatorë dhe mbetje të baterive dhe akumulatorëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 140/10, 47/11 dhe 148/11) hyri në fuqi më 01.01.2011 dhe paraqet bazë për vendosjen e sistemit për menaxhim me bateri dhe akumulatorë dhe mbetje të baterive dhe akumulatorëve.

6.1 Qëllimi i ligjit

Qëllimi i Ligjit është reduktimi i ndikimit negativ të baterive dhe akumulatorëve dhe mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve mbi mjedisin

jetësor, përmirësimit e karakteristikave të tyre ekologjike, gjatë ciklit të jetëgjatësisë së tyre, parandalimin e përdorimit të substancave të rrezikshme dhe kufizimin e përmbajtjes së tyre në bateri dhe akumulatorë. Me këtë Ligj synohet të arrihet një shkallë e lartë e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve dhe të reduktohet hedhja e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve si pjesë e mbetjeve urbane. Me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, me këtë Ligj arrihen edhe qëllimet si vijojnë:

- reduktimi i sasisë së mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve të cilat depozitohen në vendgrumbullimin e mbeturinave,
- arritje të një niveli të lartë të grumbullimit të mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve,
- arritje të një niveli të lartë të riciklimit dhe llojeve të tjera të përpunimit të mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve,
- sigurimi i kushteve për vendosjen e sistemit për veprim (kthimi mbrapsht, grumbullimi, përpunimi dhe riciklimi) të mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve,
- sigurimi i kushteve për vendosjen dhe zhvillimin e tregut të përpunimit dhe riciklimit të mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve,
- sigurimi i pozitës së barabartë në treg ndërmjet personave juridikë dhe fizikë, të vendit dhe të huaj, si dhe shmangia dhe eliminimi i barrierave tregtare të cilat mund ta çrregullojnë tregun.

6.2 Qëllimet nacionale për grumbullimin e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve

Me Ligj përcaktohen edhe qëllimet për grumbullimin e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve (të specifikuara në nenin 35 dhe 73). Qëllimet nacionale parashikojnë grumbullimin e saktë të sasisë së përcaktuar të mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve, për një afat të përcaktuar kohor, si vijon:

✓ Për vitin 2013 do të konsiderohet se janë arritur qëllimet nacionale nëse grumbullohen mbetje të baterive dhe akumulatorëve portativë në sasi prej 5% nga pesha e baterive dhe akumulatorëve portativë që janë hedhur në tregun e territorit të Republikës së Maqedonisë në vitin rrjedhës.

✓ Për vitin 2014 do të konsiderohet se janë arritur qëllimet nacionale nëse grumbullohen mbetje të baterive dhe akumulatorëve në sasi prej

12,5% të baterive dhe akumulatorëve që janë hedhur në tregun e territorit të Republikës së Maqedonisë në vitin rrjedhës.

✓ Për vitin 2015 do të konsiderohet se janë arritur qëllimet nacionale nëse grumbullohen mbetje të baterive dhe akumulatorëve në sasi prej 20% të baterive dhe akumulatorëve që janë hedhur në tregun e territorit të RM-së.

✓ Për vitin 2016 do të konsiderohet se janë arritur qëllimet nacionale nëse grumbullohen mbetje të baterive dhe akumulatorëve në sasi prej 25% të peshës së baterive dhe akumulatorëve portativë që janë hedhur në tregun e territorit të RM-së dhe

✓ Për vitin 2020 do të konsiderohet se janë arritur qëllimet nacionale nëse grumbullohen mbetje të baterive dhe akumulatorëve në sasi prej minimum 45% të peshës së baterive dhe akumulatorëve portativë që janë hedhur në tregun e territorit të RM-së.

Për arritjen e këtyre qëllimeve duhet të vendoset një sistem i qëndrueshëm për menaxhimin me mbetje të baterive, në të cilin të gjithë pjesëmarrësit do të kontribuojnë në mënyrë konsekuente konform përgjegjësisë të tyre. Pjesëmarrës kyç, për vendosjen e sistemit të suksesshëm, janë prodhuesit (importuesit) e baterive dhe akumulatorëve, tregtarët dhe poseduesit, qytetarët, komunat dhe operatorët kolektiv. Në vazhdim, shkurtimisht janë shpjeguar obligimet kryesore të secilit pjesëmarrës.

6.3 Obligimet e prodhuesve

Prodhuesi, në këtë rast, paraqitet si “ndotës” dhe i njëjti është person juridik ose fizik, i cili për herë të parë hedh në tregun e RM-së bateri dhe akumulatorë, përfshirë edhe bateri dhe akumulatorë të instaluar në pajisje ose automjete. Obligimi më i rëndësishëm i prodhuesit, përveç regjistrimit në Drejtorinë e Mjedisit Jetësor dhe etiketimit të baterive është që, në shpenzim të tij, ai vet ose përmes operatorit kolektiv, ta sigurojë grumbullimin, përpunimin dhe riciklimin e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve nga përdoruesi i fundit, pavarësisht nga përbërja e tyre kimike, prejardhja ose nga data kur për herë të parë janë hedhur në tregun e RM-së. Pastaj, prodhuesi e ka për detyrë, në llogari të vet, ta informojë dhe edukojë publikun për ndikimet e mundshme mbi mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve, për pasojat nga mosselektimi i mbetjeve të baterive, kontributin e qytetarëve në riciklimin e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve, etj.

Kompensimin që e paguan prodhuesi për menaxhimin me mbetje të baterive dhe akumulatorëve është 120 denarë/kg për bateri dhe akumulatorë portativë, 0,9 denarë/kg për bateri dhe akumulatorë plumbi për automjetet dhe industrinë dhe 8,5 denarë/kg për bateri dhe akumulatorë që nuk përmbajnë plumb për automjetet dhe industrinë. Kompensimi përlogaritet në bazë të neto peshës.

Nga obligimet, për kompensimin dhe grumbullimin e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve, lirohen të ashtuquajturit **prodhues të vegjël**, përkatësisht ata të cilët në nivel vjetor importojnë më pak se 50 kg bateri portativë, 10 kg pila në formë kopse dhe 100 kg akumulatorë automjeti.

6.4 Obligimet e tregtarëve dhe poseduesve

Tregtarët dhe poseduesit nuk duhet të posedojnë licencë për grumbullimin e mbetjeve të rrezikshme, por e kanë për detyrë të vendosin enë përkatëse për grumbullimin e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve portativë në hapësirat e tyre dhe pa kompensim ose obligim për blerje nga përdoruesi i fundit t'i grumbullojnë, pavarësisht asaj se kush është prodhuesi i tyre. Mbetjet e grumbulluara të baterive dhe akumulatorëve e kanë për detyrë t'ia dorëzojnë prodhuesit, apo personit të autorizuar nga ai, për grumbullimin e të njëjtave.

6.5 Obligimet e qytetarëve

Qytetarët, mbetjet e baterive dhe akumulatorëve, duhet t'i ruajnë ndaras nga pjesa tjetër e mbeturinave. Ndalohet që mbetjet e baterive dhe akumulatorëve të hidhen në vende që janë caktuar për mbetje urbane. Nëse inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor gjen bateri në mbetjet urbane ka të drejtë të shqiptojë gjobë në lartësi prej 60 euro të cilën kryerësi e ka për detyrë ta paguajë në afat prej tetë ditësh.

6.6 Obligimet e komunave

Kryetari i komunës e ka për detyrë të përcaktojë pika të veçanta grumbullimi për mbetjet e baterive dhe akumulatorëve dhe të organizojë sistem grumbullimi dhe magazinimi të përkohshëm të mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve portativë, si dhe dorëzimin e tyre për trajtim, përpunim dhe/ose riciklim. Këto punë, kryetari i komunës i kryen në bashkëpunim me operatorin kolektiv, me të cilin nënshkruan kontratë dhe siguron

grumbullim të rregullt të mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve nga pikat e grumbullimit dhe qendrat e grumbullimit. Qendrat e grumbullimit dhe pikat e grumbullimit mund të vendosen në hapësirat e poseduesve dhe tregtarëve, në institucione shkencore-arsimore, në tregjet e fruta-perimeve, në hapësira publike në të cilat pritet që përdoruesit e fundit t'i depozitojnë mbetjet e baterive dhe akumulatorëve. Pikat e grumbullimit, në shkollat fillore dhe të mesme, janë të dedikuara ekskluzivisht për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve portativë.

Numri i pikave të grumbullimit duhet të jetë në përputhje me dendësinë e popullatës, përkatësisht më së paku një pikë grumbullimi për 1000 banorë për bateri dhe akumulatorë portativë ose më së paku një pikë grumbullimi për 5000 banorë për mbetje të baterive dhe akumulatorëve për automjete.

6.7 Obligimet e operatorëve kolektiv

Operatori kolektiv duhet të vendos sistem për veprim dhe t'u mundësojë përdoruesve të fundit t'i depozitojnë mbetjet e baterive dhe akumulatorëve portativë në pika të aksesshme të grumbullimit, në afërsinë e tyre, duke e pasur parasysh dendësinë e popullatës; t'i obligojë poseduesit dhe tregtarët që pa pagesë t'i pranojnë mbetjet e baterive ose akumulatorëve portativë përmes lidhjes së kontratës, me ç'rast nuk guxojnë të imponojnë kurrfarë shpenzimesh për përdoruesit e fundit, e as të imponojnë kurrfarë obligimi për blerje të baterive ose akumulatorëve të ri. Operatori kolektiv mund të veprojë me mbetje të baterive dhe akumulatorëve në llogari të prodhuesve nëse ai ka lidhur kontratë me prodhues, të cilët bashkë hedhin në treg së paku 15% bateri dhe akumulatorë portativë brenda një viti kalendarik. Nëse këto obligime nuk plotësohen, operatorëve kolektiv u shqiptohen sanksione për kundërvajtje në shumë prej 9000 deri më 35 000 euro.

6.8 Obligimet e inspektorëve të mjedisit jetësor dhe sanksionet

Për implementimin konsekuent të obligimeve ligjore ngarkohet Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor, përkatësisht për punët në kompetencë të komunave, këtë e bëjnë inspektorët e autorizuar të mjedisit jetësor dhe inspektorët komunal për pjesën e obligimeve të qytetarëve.

Neni 45 i Ligjit e rregullon fushëveprimin e mbikëqyrjes së inspektorit shtetëror të mjedisit jetësor, ndërsa neni 47 e rregullon fushëveprimin

e mbikëqyrjes së inspektorëve të autorizuar të mjedisit jetësor dhe inspektorëve komunal të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit. Inspektorët duhet të bëjnë inspektim dhe kontroll mbi të gjithë pjesëmarrësit e parashikuar me Ligj dhe të konstatojnë nëse vepron në përputhje me dispozitat ligjore. Nëse konstatojnë parregullsi ose mospërmbushje të obligimeve, atëherë kanë të drejtë të nxjerrin aktvendime (neni 46 dhe 48), të cilët lëvizin nga ndalimi i punës së subjektit, për një afat të caktuar kohor, deri në përcaktimin e sanksioneve për kundërvajtje dhe dënimeve.

Për prodhuesit sanksionet për kundërvajtje përcaktohen nga neni 53 deri në nenin 58, ndërsa gjobat për parregullsi në punë lëvizin prej 300 deri në 6000 euro. Sanksionet për kundërvajtje për poseduesit dhe tregtarët përcaktohen në nenin 58, ndërsa gjobat lëvizin prej 700 deri në 2000 euro. Neni 59 i përcakton sanksionet për kundërvajtje, që kanë të bëjnë me përdoruesit e fundit, ndërsa gjobat lëvizin nga 200 deri në 1000 euro, ndërsa gjoba për personat fizikë (nenin 60) është 60 euro. Gjoba për operatorin kolektiv, i cili nuk vepron në përputhje me dispozitat ligjore, është prej 1500 deri në 35 000 euro.

Inspektori shtetëror, përkatësisht inspektori i autorizuar i komunës, e ka për detyrë të hartojë raport tremujor për evidencën e mbikëqyrjeve dhe inspektimeve dhe ta publikojë në ueb-faqen e autoritetit shtetëror ose autoritetit të administratës lokale.

Afatet dhe përgjegjësitë kryesore janë pasqyruar në Tabelën 6.1

Çka?	Periudha kohore	Prej kujt?	Neni i Ligjit
Programi për menaxhimin me mbetje të baterive dhe akumulatorëve	Deri 31 dhjetor 2011	Drejtoria e Mjedisit Jetësor	Neni 36
Evidenca e sasive dhe llojeve të baterive dhe akumulatorëve të hedhura në treg në RM gjatë vitit kalendarik	Nga 1 janari 2011	Prodhues	Neni 30 (6)
Etiketimi i baterive dhe akumulatorëve	Nga 1 janari 2012	Prodhues	Neni 10
Ndalimi i importit të baterive dhe akumulatorëve pa certifikatë regjistrimi dhe panumër regjistrimi	Nga 1 janari 2012	Prodhues	Neni 13

Vendosja e enëve për grumbullimin e mbetjevetë baterive dhe akumulatorëve	Nga 1 janari 2015	Tregtarë dhe posedues	Neni 17
Raport në të cilin përshkruhet gjendja emenaxhimit me bateritë dhe akumulatorët që janë hedhur në treg gjatë tre viteve të fundit	Deri më 30 maj 2013	Organi profesional	Neni 70 paragrafi (9)
Vendosja e enëve për depozitimin e mbetjevetë baterive dhe akumulatorëve	Nga 1 janari 2015	Tregtarë dhe posedues	Neni 70 paragrafi (7)
Riciklimi i 65% të peshës mesatare të baterivedhe akumulatorëve me acid plumbi; Riciklimi i 75% të peshës mesatare të baterivedhe akumulatorëve me nikel-kadmium; Riciklimi i 50% të peshës mesatare të mbetjevetë tjera të baterive dhe akumulatorëve.	Deri më 31 dhjetor 2016	Prodhues	Neni 26

TABELA 6.1

7. GJENDJA NË MAQEDONI

Deri në momentin e përpilimit të këtij Manuali, në Maqedoni janë regjistruar 477 prodhues, përkatësisht importues të cilët për herë të parë hedhin bateri në tregun e RM-së. Disa nga prodhuesit e regjistruar importojnë bateri në mënyrë të njehershme dhe ata nuk trajtohen si prodhues.

Me obligimin për regjistrimin e firmave gjatë importit të baterive dhe akumulatorëve mund të vijmë deri te të dhënat e sasisë së importuar të akumulatorëve, megjithatë akoma mungojnë informatat për bateritë portative, ndërsa akoma më shumë për atë se çka ndodhë më tutje me të njëjtat. Disa hulumtime, të realizuara paraprakisht, na japin disa indikatorë, por nuk kemi të dhëna zyrtare për mbetjet e gjeneruara nga bateritë portative.

Sipas hulumtimit, të realizuar në vitin 2010, nga organizata joqeveritare 4x4x4 Ballkanski Mostovi, u konstatua se sasitë e baterive portative lëvizin ndërmjet 220 000 dhe 270 000 kg, përkatësisht prej 220 deri në 270 tonë bateri, të cilat përdoren dhe depozitohen për një vit në Republikën e Maqedonisë. Për metodologji janë marrë tri komuna të ndryshme dhe vendgrumbullimet e mbeturinave të tyre (Drislla, Ohër dhe Dellçevë), përkatësisht janë matur sasitë e mbetjeve të baterive të cilat depozitohen nga kamionët, të cilët transportojnë mbetje urbane, në vendgrumbullimet e mbeturinave.

Sipas hulumtimit të realizuar në vitin 2012 nga Instituti Maqedonas për Media (IMM), në nivel vjetor gjenerohen rreth 5 642 960 copë të mbetjeve të baterive. U shpërndanë 1000 pyetësorë nëpër amvisëri, sipas zgjedhjes së rastësishme, nga të cilët u morën 205 përgjigje. Sipas përgjigjeve një amvisëri mesatarisht blen 10 bateri brenda vitit, ndërsa nëse këtë numër do ta shumëzojmë me 564 296 amvisëri, rezulton se 5 642 960 copë mbetje të baterive gjenerohen në nivel vjetor.

7.1 Operatorët kolektiv

Licencë për operim kolektiv kanë dy subjekte private, të cilët aktualisht përfshijnë rreth 15% nga prodhuesit të cilët hedhin në treg bateri dhe akumulatorë. Operatorët kolektiv të cilët posedojnë licencë janë: OBA Riciklim dhe "Nulla Otpad" ("Zero Mbetje") SHPK.

Operatori kolektiv "OBA Riciklim", me numër të licencës 11-2319/4 nga 16.3.2012, është firmë nga Shtipi. OBA ka lidhur kontratë për operimin dhe trajtimin e mbetjeve të baterive me "Ival Tejd" SHPK, firmë e cila nga viti 1994 riciklon deri në 85% të mbetjeve të akumulatorëve me plumb në Republikën e Maqedonisë.

Operatori kolektiv "Nulla Otpad", me numër të licencës 11-8349/3 nga 19.10.2012, është firmë nga Shkupi e cila ka lidhur kontratë për riciklim me "F Grupacion" SHPK, e cila paraqet filial të "EE Reciklazh" dhe "Tab Mak" SHPK Shkup, person juridik për përpunimin dhe riciklimin e mbetjeve të akumulatorëve e cila posedon licencë, në përputhje me Ligjin për menaxhim me mbeturina nr. 11-6595/3.

"OBA Riciklim" ka nënshkruar kontrata me 30 (tridhjetë) firma, të cilat importojnë 3927,25 kg bateri portative (rreth 4 tonë) dhe 7,06 kg pila në formë kopse në nivel vjetor. "OBA" ka grumbulluar dhe magazinuar rreth 1500 kg bateri portative.

“Nulla Otpad” SHPK ka nënshkruar kontrata me 62 firma, të cilat importojnë rreth 37 500,00 kg (37,5 tonë) bateri të vogla portative në nivel vjetor. “Nulla Otpad” SHPK ka grumbulluar dhe magazinuar rreth 2000 kg (2 tonë) bateri portative.

Operator kolektiv	Kontrata të nënshkruara	Importi i baterive (tonë)	Të grumbulluara (tonë)
“OBA Reciklim”	30	4	1,5
“Nulla Otpad” SHPK	62	37,5	2
Gjithsej	82	41,5	3,5

TABELA 7.1

Janë regjistruar 477 prodhues (importues), ndërkaq nuk ka informata të sakta për numrin e tregtarëve dhe distributorëve dhe për sasitë e baterive portative që importohet në RM. Obligimi ligjor i tregtarëve dhe distributorëve u fillon më 01.01.2015.

Operatorët kolektiv kanë vendosur rreth 200 enë për grumbullimin e mbetjeve të baterive, ndërsa sipas Ligjit duhet të ketë më së paku një pikë grumbullimi për bateri portative për çdo 1000 banorë. Nëse e marrim parasysh se në RM ka diç më shumë se 2 milionë banorë, atëherë do të duhej të vendosen rreth 2000 enë për grumbullimin e mbetjeve të baterive.

Sa u përket komunave, operatorët kolektiv deri më tani kanë nënshkruar kontrata me 7 komuna dhe me Qytetin e Shkupit. Në Tabelën 7.2 është pasqyruar gjendja aktuale, si dhe sa ka mbetur për zhvillimin e sistemit të menaxhimit me mbetje të baterive në Republikën e Maqedonisë.

Subjekti	Gjithsej	Gjendja aktuale	Potenciali (mbetet për t’u bërë)
Prodhues (importues)	477	92 kontrata të nënshkruara me OK	385 kontrata
Komuna	81	8 kontrata të nënshkruara me OK	73 komuna të organizojnë sistem
Enë	2020	200 të vendosura	Të vendosen 1820 enë
Qytetarë	2020365	Sistem për 348.000 qytetarë	1672237 banorë të sigurohen me sistem

TABELA 7.2

7.2 Trajtimi dhe përpunimi

Aktualisht, aktivitetet për përpunimin dhe riciklimin e mbetjeve të baterive, janë shumë të kufizuara dhe akoma nuk është vendosur një qasje e organizuar. Marrë në përgjithësi, shfrytëzimi i shumë materialeve që mund të riciklohen në kushtet ekzistuese nga aspekti financiar është i paleverdishëm. Për fat të keq, akoma kemi raste kur me riciklimin e materialeve me potencial të riciklimit, siç janë akumulatorët e automjeteve, në numër të madh merren kompanitë private dhe sektori joformal, duke i shfrytëzuar pikat e grumbullimit të skrapit me ndikime potenciale negative mbi mjedisin jetësor dhe shëndetin e popullatës.

Tregu i riciklimit të mbetjeve të baterive në Maqedoni nuk është i zhvilluar (me përjashtim të akumulatorëve të automjeteve). Person i vetëm juridik është "Tab Mak" SHPK nga Probishtipi (ish "VESNA SAP" SHPK nga Probishtipi), i cili posedon licencë të integruar ekologjike – A nr. 11-2486/2, në përputhje me Ligjin për mjedisin jetësor, si dhe posedon licencë për kryerjen e veprimtarisë për grumbullimin, trajtimin dhe ripërpunimin e baterive për automjete.

7.3 Vetëdija publike dhe edukimi

Sipas hulumtimit të IMM-së, në vitin 2012, 96% e qytetarëve janë të vetëdijshëm se bateritë janë mbetje e rrezikshme, ndërsa 50% e qytetarëve të RM-së e dinë se ku duhet t'i depozitojnë mbetjet e baterive. Numri më i madh i qytetarëve (55%) i hedhin bateritë bashkë me mbetjet urbane, ndërkaq vetëm 16% i depozitojnë në pikat e grumbullimit, përkatësisht 29% i depozitojnë në enët/koshat special të vendosur nëpër supermarkete.

Në sferën e vetëdijes publike dhe edukimit në mënyrë të vazhdueshme punon Organizata Ekologjike Rinore "Gou Grin", e cila e zhvillon projektin për mbetje të baterive të quajtur "Gou Klin", që nga fillimi i nismës në vitin 2011. Qasja e kësaj shoqate quhet "pay it forward", përkatësisht çdo pjesëmarrës në ligjëratat edukative e ka për detyrë që informatën tua transmetojë më së paku tre personave të tjerë. Fokusi kryesor është mbi nxënësit e shkollave të mesme, të cilët pastaj i informojnë dhe i edukojnë nxënësit e shkollave fillore. Nga fillimi e deri më sot janë realizuar mbi 100 ligjëratat edukative nëpër shkollat fillore dhe 7 seminare për nxënësit e shkollave të mesme që iu përkushtuan mbetjeve të rrezikshme dhe baterive. Në vitin 2014 në këtë projekt u përfshin 7 komuna dhe shkollat e tyre (gjithsej 78), të cilat do të garojnë për grumbullimin e baterive, me qëllim të rritjes së vetëdijes tek nxënësit dhe prindërit e tyre dhe

për grumbullimin e 1000 kg mbetjeve të baterive. Përveç Ambasadës së Mbretërisë së Suedisë, e cila e ka iniciuar dhe mbështetur tërë procesin nga viti 2011, Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë është donatore e vazhdueshme e projektit. Më shumë për këtë projekt mund të lexoni në www.gogreen.mk.

7.4 Bashkëpunimi ndërkombëtar

Si pjesë e projektit “Gou Klin”, në vitin 2012, u vendos një bashkëpunim me dy kompani të cilat mund të jenë destinacione potenciale për riciklimin e baterive nga Maqedonia.

Kompania nga Sllovakia “MACH Trade” riciklon bateri nga vendet e Evropës Verilindore. Kjo kompani prodhon zink, plumb, polipropilen, sulfat sodiumi dhe elemente të tjerë nga bateritë e ricikluara. Kapaciteti prodhues për riciklimin e baterive është 1 ton për 1 orë. Nevojitet një sasi e madhe e baterive në mënyrë që kapaciteti prodhues të jetë optimal, së këtejmi “MACH Trade” investon shumë në edukimin e të rinjve, vendosjen e enëve dhe pikat e grumbullimit, gara, fushata edukative nëpër shkolla dhe ngjashëm. Më shumë informacione për këtë kompani mund të gjeni në ueb-faqen www.machtrade.sk

Kompania nga Greqia, “POLYECO”, nga viti 2006, ka vendosur sistem për grumbullimin e mbetjeve të baterive me infrastrukturë të vet transportuese dhe i mbledh bateritë nga pikat e grumbullimit të AFIS. AFIS (www.afis.gr) është Autoriteti Kombëtar për Menaxhimin me Mbetjet e Baterive dhe Akumulatorëve në Greqi. “POLYECO” është anëtare e Asociacionit Evropian për Riciklimin e Baterive www.polyeco.com.gr dhe ka zhvilluar një bashkëpunim me fabrika në vende të tjera, në të cilat i eksporton sasitë e grumbulluara për riciklim.

8. PËRVOJAT E SUEDISË

Sistemi i menaxhimit me mbetje të baterive dhe akumulatorëve në Suedi ka filluar që në vitet e shtatëdhjeta. Sot, Suedia, është njëri nga vendet lider në grumbullimin dhe riciklimin e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve. Në Foto 8.1 është pasqyruar procesi i sistemit në Suedi.

Grumbullimi dhe riciklimi i baterive në Suedi

Prodhuesi i informon
përdoruesit për:

Efektet potenciale mbi
shëndetin e njeriut
dhe mjedisin jetësor

Pikat e grumbullimit

Prodhuesi

Bateri në treg

Konsumatorë

Mbetjet e baterive

Grumbullimi

Riciklimi

Depozitimi

Kursimi i energjisë

Lëndë të para

Prodhuesi gjithashtu:

Regjistrohet në
Agjencinë Suedeze të
Mjedisit Jetësor

Jep raport për bateritë
e shitura, grumbulluara
dhe sasitë e
ripërpunuara të baterive

E organizon grumbullimin
dhe riciklimin e baterive

Bashkëpunon me
komunat rreth
grumbullimit të baterive

FOTO 8.1.

Në tabelat në vijim janë pasqyruar nivelet e shitjes dhe grumbullimit të baterive për periudhën kohore 2009-2012. Sasitë janë shprehur në tonë.




TABELA 8.1

Nga Tabela 8.1 mund të vërejmë se përqindja e grumbullimit të baterive portative është 63%.




TABELA 8.2

Nga Tabela 8.2 mund të vërehet se shitja e baterive me nikel-kadmium është reduktuar në mënyrë drastike, ndërsa kjo është për shkak të toksicitetit dhe tendencës që tërësisht të hiqen nga përdorimi, gjë të cilën e imponon edhe legjislacioni evropian.




TABELA 8.3

Nga Tabela 8.3 mund të shihet shkalla e grumbullimit të baterive dhe akumulatorëve portativë me plumb, e cila arrin madje deri më 90% dhe e konfirmon biznesin e zhvilluar me plumb.

Bateri portative me litium




TABELA 8.4

Nga Tabela 8.4 mund të vërehet një rritje rapide e shitjes së baterive me litium të cilat reciklohen lehtë dhe kanë ndikim të vogël të rrezikshmërisë mbi mjedisin jetësor.

Bateri automobilistike me plumb




TABELA 8.5

Nga Tabela 8.5 mund të vërehet sasi jashtëzakonisht e madhe e baterive automobilistike me plumb në tregun e Suedisë dhe shkalla e grumbullimit të tyre, e cila është rreth 75%.




TABELA 8.6

Nga Tabela 8.6 mund të vërehet se një qytetar mesatar i Suedisë blen rreth gjysmë kilogram bateri në vit, ndërkaq shkalla e grumbullimit është 63%.

Sipas deklaratave të ekspertit nga Agjencia e Suedisë për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor, z. Lars Eklund, i cili më 8.11.2011 mbajti një prezantim në EU-Info Qendrën në Shkup, me temën çka është e nevojshme për vendosjen e sistemit të suksesshëm dhe të qëndrueshëm:

- Legjislacioni dhe monitorimi – informim i vazhdueshëm dhe njoftimi me Ligjin, veçanërisht për ata të cilët janë përgjegjës për implementimin e tij, monitorimin dhe supervizionin nga ana e inspektorëve të mjedisit jetësor, bashkëpunimi me dhe midis institucioneve, kompanive dhe organizatave.
- Aksesit dhe praktikiteti – nevojitet vendosja e një numri të madh të pikave të grumbullimit, të hapura 24/7, distancë e shkurtër deri te pikat e grumbullimit, zhvillim dhe implementim të ideve dhe zgjidhjeve kreative në këtë drejtim.
- Njohuri dhe vullneti i fuqishëm – konsumatorët duhet t’i dinë të gjitha faktet, rreziqet dhe pasojat nga mbetjet e baterive, si dhe përfitimet nga riciklimi, fushata e vazhdueshme për zhvillimin e vetëdijes dhe edukimi, krijimi i ndjenjës së përgjegjësisë tek secili qytetar.
- Përgjegjësi dhe financim – të gjithë aktorëve, qartë duhet t’u bëhet me dije se kush e bën grumbullimin, riciklimin dhe informimin, përkatësisht monitorimin mbi prodhuesit dhe operatorët kolektiv.

- Marrëdhënie korrekte – në rastin e më shumë operatorëve kolektiv, duhet të ketë një trajtim korrekt nga ana e të gjithë aktorëve, të inkurajohet bashkëpunimi midis tyre dhe të përfshihet sektori joformal.

9. SFIDAT DHE MUNDËSITË: MBETJET E PAJISJEVE ELEKTRIKE DHE ELEKTRONIKE

Mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike (MPEE) konsiderohen si mbetje me rritje më të shpejtë në BE, me një shkallë të rritjes prej 3 deri në 5%, që është tre herë më shumë nga shkalla e rritjes së mbetjeve urbane. Bateritë janë pjesë e pashmangshme e pajisjeve elektrike dhe elektronike, e cila karakterizohet me një zhvillim më të shpejtë teknologjik dhe me një cikël të lartë inovacionesh, ndërsa kjo prodhimtari është një nga industritë përpunuese me rritje më të shpejtë në botë. Në BE shiten prej 11 deri 12 milionë tonë MPEE në nivel vjetor, ndërsa përqindja më e madhe në masë i takon spektrit të gjerë të pajisjeve elektro-shtëpiake, si dhe të pajisjeve informatike dhe telekomunikacionit. Sa më shumë që zgjerohet tregu i MPEE, aq më shumë ciklet inovative bëhen më të shkurtër, përshpejtohet edhe zëvendësimi i pajisjeve.

Sistemi MPEE bazohet mbi parimet e njëjta si edhe sistemi i menaxhimit të mbetjeve të baterive, përkatësisht Ligji i rregullon marrëdhëniet dhe obligimet e aktorëve të përmendur në këtë Manual. Ligji për pajisje elektrike dhe elektronike dhe mbetje të pajisjeve elektrike dhe elektronike në RM hyri në fuqi më 01.01.2013. Fakti se këto lloj mbeturinash kanë të njëjtat metale toksike në përbërjen e tyre , dhe ligjet janë të bazuara në të njëjtat parime, krijon mundësi për sinergji në zbatimin e dy sistemeve, dmth të sistemit të menaxhimit të baterive dhe akumulatorëve dhe sistemit të mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike.

Në raport me prodhuesit, kjo do të thotë se do të ketë numër shumë më të konsiderueshëm firmash që do të duhet të paguajnë dhe të investojnë në sistemin. Kontraktuesit kolektiv që kanë leje për të menaxhuar bateritë e hedhura kanë mundësinë për të menaxhuar mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike, ndërsa komunat do të mund të lidhin kontratë me një kompani që ka një licencë të tillë, në vend me dy veç e veç. Në këtë mënyrë do të kursehet kohë dhe burime dhe do të rriten aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit, edukimin dhe nxitjen e themelimit të një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e këtij lloji të mbeturinave.

10. REKOMANDIME PËR ZHVILLIMIN E SISTEMIT TË SUKSESSHËM

Nga vështrimi i përgjithshëm i gjendjes në Republikën e Maqedonisë veçohen këto rekomandime për zhvillimin e sistemit të suksesshëm për menaxhimin me mbetjet e baterive:

LEGJISLACIONI

- ✓ Ndryshime të Ligjit në përputhje me përvojat e deritanishme nga procesi i implementimit, me qëllim të tejkalimit të barrierave të caktuara të cilat paraqiten dhe mundësojnë implementim real të Ligjit (për shembull, tejkalimi i problemit me “prodhues i vogël” dhe krijimi i konkurrencës jolojale midis prodhuesve, lartësisë së kompensimit për veprim dhe ngjashëm).
- ✓ Gjatë implementimit të Ligjit të merren parasysh edhe dispozitat e Ligjit për mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike.

INFORMIMI DHE EDUKIMI

- ✓ Mbajtja e regjistrit për regjistrimin e saktë të të gjitha subjekteve të cilët operojnë me mbetje të baterive.
- ✓ Stimulimi i hulumtimit dhe përmirësimi i karakteristikave të përgjithshme ekologjike të baterive dhe akumulatorëve dhe zhvillimi i marketingut të baterive dhe akumulatorëve të cilët përmbajnë sasi më të vogla të substancave të rrezikshme, apo të cilët përmbajnë më pak substanca ndotëse (zhivë, kadmium dhe plumb).
- ✓ Hulumtimi i potencialit dhe vlerësimi ekonomik për hapjen e fabrikës për riciklimin e mbetjeve të baterive dhe mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike në rajon.
- ✓ Të përforcohet mbikëqyrja mbi prodhuesit të cilët hedhin në treg bateri dhe akumulatorë.
- ✓ Të bëhet një analizë e mirëfilltë e sasive të baterive dhe akumulatorëve të importuar/prodhuar dhe të hedhur në tregun e RM-së.

PRODHUESIT

- ✓ Zhvillimi i Programit për përgjegjësi shoqërore, i cili do të jetë pjesë e përcaktimit strategjik të firmës, me buxhet të veçantë për realizim.
- ✓ Tejkalimi i problemit me “prodhues i vogël” dhe krijimi i konkurrencës jolojale midis prodhuesve.
- ✓ Rregullimi i minimum kompensimit me qëllim të sigurimit

të qëndrueshmërisë së sistemit. Kompensimi duhet të jetë mjaftueshëm i lartë që të mbulohen shpenzimet dhe mjaftueshëm i ulët që prodhuesit të kenë mundësi të paguajnë.

- ✓ Organizimi i ngjarjeve për rrjetëzimin e prodhuesve, tregtarëve dhe distributorëve, me qëllim të bashkëpunimit dhe zhvillimit të programeve të përbashkëta.

KOMUNAT

- ✓ Nënshkrimi i kontratave me operatorët kolektiv dhe përcaktimi i pikave të grumbullimit për mbetjet e baterive për qytetarët.
- ✓ Fushatë e përforcuar publike dhe e vazhdueshme për ngritjen e vetëdijes.
- ✓ Bashkëpunimi me organizata joqeveritare për edukimin dhe aktivizimin e të rinjve

OPERATORË KOLEKTIV

- ✓ Lokacionet e pikave të grumbullimit të publikohen në ueb-faqe e që do t'u mundësojë qytetarëve një pasqyrë të qartë se ku mund t'i depozitojnë bateritë e tyre të zbrazëta.
- ✓ Paraqitja e rregullt e raporteve vjetore pranë Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në RM (në përputhje me Ligjin) dhe publikimi i tyre transparent në ueb-faqe.
- ✓ Bashkëpunimi i operatorëve kolektiv për reduktimin e shpenzimeve dhe mbështetjes së ndërsjellë në procesin e organizimit të sistemit, me qëllim që të gjithë qytetarët e RM-së të kenë mundësi/shërbime të barabarta.

QYTETARËT DHE TË RINIA

- ✓ Punëtori të vazhdueshme edukative nëpër shkolla dhe kopshte.
- ✓ Fushata promovuese dhe gara për grumbullimin e baterive.
- ✓ Lajmërim të operatorëve kolektiv për enët (koshat) e mbushura me bateri dhe enët e dëmtuara.

FINANCIMI

- ✓ Shfrytëzimi i fondeve evropiane, si burim për financimin e projekteve, për zhvillimin e sistemit.
- ✓ Zhvillimi i projektit rajonal për grumbullimin e baterive dhe shfrytëzimin e fondeve vendase dhe rajonale.
- ✓ Lidhja e bashkëpunimit dhe formimi i konzorciumit për zmadhimin e kapaciteteve dhe fonde më të aksesshme për financimin e projekteve.

LITERATURA E PËRDORUR:

4x4x4 Ballkanski Mostovi (Ura Ballkanike), "Çka janë bateritë dhe akumulatorët:", 2007-2010

Agjencia e Suedisë për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor, "Batteriesstatistik 2009-2012.xls"

Bebkok Hejli, "Elektronika dhe e-mbetjet – Udhëzues për përfaqësim dhe lobim", viti 2011, Fondacioni "Metamorfozis"

Eklund L. "System in Sweden_Ekhlund_SEPA_presentation 2011" nga prezantimi më datë 08.11.2011 në BE Info- Qendrën, Shkup

Eriko – Instituti për Zhvillim Ekologjik, "Plani për menaxhimin e mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike me studim fizibiliteti për periudhën kohore 2013 – 2020", prill 2011, www.erico.si

Ligji për bateri dhe akumulatorë dhe mbetje të baterive dhe akumulatorëve, "Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 140/10, 47/11 dhe 39/12

Matson S., Eklund L, Maznevska A., Apostollova I. "Vlerësimi i gjendjes me menaxhimin e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve në Republikën e Maqedonisë", shkurt 2013.

<http://ec.europa.eu/environment/waste/batteries/>

<http://www.epbaeurope.net/recycling.html>

<http://www.batteriatervinningen.se/>

www.e-otpad.mk

www.oba.mk

www.nulaotpad.com.mk

RRETH AUTORIT:

Antonio JOVANOVSKE është ekonomist i diplomuar në Universitetin "Shën Cirili dhe Metodi" dhe student në studimet master për "Ekonomi ekologjike dhe zhvillim të qëndrueshëm" në Institutin e Biznesit dhe Ekonomisë në Shkup. Aktivist qytetar që nga viti 2003 dhe mbajtës i pozitave drejtuese në AIESEC Maqedoni dhe Francë, Go Green Shkup, Ajde Maqedoni dhe Këshillin Kombëtar Rinor të Maqedonisë.

antonio@bidizelen.org